

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**GENERAL TRADING sh.p.k**

Bazuar në ligjin nr.9901 dt.14.04.2008” Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar,me vullnetin e tyre të lirë,të shprehur në nënshkrimin e këtij akti,sot më datë **22 Shkurt 2022** themeluesit;

**1. Fabiola PETRITAJ**

**DEKLARON**

Nënshkrimin e kësaj kontrate themelimi, për krijimin e shoqërisë me përgjegjesi të kufizuar **GENERAL TRADING sh.p.k** ,më poshtë referuar si “Shoqëria”.

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga Akti i themelimit, Statuti i shoqërisë dhe legjislacioni shqiptar për shoqëritë tregtare.

**Neni 1-Emërtimi**

1.Shoqëria emërtohet **GENERAL TRADING sh.p.k**, Emërtimi mund te shkruhet me shkronja të mëdha dhe të vogla.

**Neni 2-Selia**

2.Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në **Zona kadastrale 2953, nr pasurie 72/28 rruga Ben Mjalti,njesia administrative Peze, Tirane.**

2.1Shoqëria sipas parashikimeve te statute dhe legjislacionit në fuqi mund të hapë si ne Shqipëri ashtu edhe jashtë saj përfaqësi, filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

**Neni 3- Kohëzgjatëja**

3. Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar nga data e rregjistrimit të saj në Qëndrën Kombëtare të rregjistrimit. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë,me vendim të Asamblese së ortakëve.

**Neni 4- Objekti**

4.1 Shoqëria **GENERAL TRADING sh.p.k** ka si objekt të veprimtarisë tregtare së saj,po pa u kufizuar;

-Import - Eksport dhe tregetimi i artikujve te ndryshem industrial, bujqesor, materiale ndertimi, pajisje elektronike, pajisje dhe materiale hidraulike dhe elektrike, vegla pune,veshmbathje, konfeksione, hidrosanitare, hidraulike,elektrike, detergjente, artikuj tualeti dhe kozmetike, kancelari per zyra dhe shkolla, orendi shtepiake, mobilje, pajisje elektrike, elektronike e elektroshtepiake, fruta perime, artikuj industrial ushqimor dhe blegtoral, bime medicinale e eterovajore, pije te ndryshme alkoolike e freskuese.Tregetimi i te gjitha llojeve te mallrave, materialeve, automjeteve me goma dhe zinxhire te tipeve te ndryshme, makinerive, pajisjeve dhe impjanteve te ndryshme te karakterit publik, industrial, bujqesor, tregetar, kulturor,sportiv, sherbimeve,pjese kembimi,goma te ndryshme, bateri automjetesh dhe vajra lubrifikante. Tregetimi i pajisjeve elektronike, kompjutera, kancelari, aksesoree tregetim te materialeve

duralumini, plastike dhe druri, dyer e dritare shkollore. Tregëtim të pajisjeve laboratorike, transformator, elektromotorr, gjeneratore, pompa dhe elektropompa si dhe riparim-sërbim për transformatore, elektromotorre dhe materialet e tjera. Tregëtimi import eksport të materialeve dhe pajisjeve industriale, elektro-shtëpiake, pajisjeve e sistemeve të impianteve të ftohjes, ngrohjes, kondicionere si dhe impiante të tjera të ndryshme të çfardo lloji. Projektim dhe instalim i pajisjeve elektrike, industriale, elektroshtëpiake, sistemeve të ftohjes-ngrohjes, kondicionere, sërbime mirëmbajtje dhe servisi të ndryshme për materialet e pajisjet elektrike dhe industriale. Tregëtim i kimikateve dhe pesticideve si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për të realizimin e qëllimit të shoqërisë dhe që nuk bie në dësh me legjislacionin shqiptar në fuqi. Tregëtim kaseta të matesave të ujit, panele dhe konstruksione metalike. Tregëtim materiale pastrimi dhe detergjente, artikuj hotelerie, enë kuzhine, veshje dhe pajisje pune. Tregëtim me shumicë dhe me pakicë të artikujve të tekstilit, perdeve, veshjeve dhe konfeksioneve të ndryshme. Gjithashtu, shoqëria gjatë aktivitetit të saj ka të drejtë të perdorë marken e vet tregtare, të bëjë marketingun e prodhimeve dhe sërbimeve të saj si në vend ashtu edhe jashtë tij. Ndertime civile, bujqësore, turistike. Rikonstruksione. Punime karpanierie. Punime dhe ndertime hidraulike dhe hidroteknike. Ndertime ujsjellesi, kanalizime, impinte vaditje, kanale, puse etj. Nderim vepra të vecanta kulla, sillose, struktura b/arme dhe metalike, punime nëntoksore dhe themeli. Nderim linjave të shfrytëzimit dhe pasurimit të uji të pishem, tregëtim i ujit të pishem. Punime restaurimi, restaurimi i monumenteve të kultures dhe veprave të vecanta arkeologjike. Nderim rrugë të kategorive të ndryshme dhe shtresa në rrugë, Ndertime dhe punime hekurudhore; punime speciale të shinave dhe traversave; punime të sistemit elektrik dhe sinjalistik. Ndertime autostrada, pista aeroporte. Punime mirëmbajtje dhe sinjalizim në rrugë. Nderim ura dhe vepra arti. Ndertime tunele rrugore dhe hekurudhore. Ndertime basene. Punime thellimi dhe drenimi. Punime sërbimi, punime në sipërfaqe të gjelbërta parqe pyll; pastrim i sipërfaqeve urbane, mirëmbajtje dhe zhyllim i sipërfaqeve urbane dhe dekorit – ndricime e sinjalizime. Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim, asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme përfshirë ato spitalore dhe të rrezikshme. Sërbime pastrimi të ndryshme të ambjentëve të brendshme dhe të jashtëme.

### **Neni 5 Kapitali i rregjistruar**

5.1 Kapitali i rregjistruar i shoqërisë është 100 (një qind) lekë. Kapitali i rregjistruar është i përbërë nga 1 kuotë kapitali me vlerë nominale 100 (një qind) lekë secila të gjitha të nënshkruara e të paguara. Kuotat e nënshkruara të kapitalit janë shlyer tërësisht nga themeluesit.

### **Neni 6 Kuotat e kapitalit të rregjistruar**

6.1 Sipas kontributeve në kapitalin e rregjistruar të shoqërisë kuotat ndahen :

**-Fabiola PETRITAJ 100% të kapitalit.**

### **Neni 7-Kuotat dhe kalimi i kuotave të kapitalit**

7.1 Zotërimi i kuotave, mënyra e fitimit dhe kalimit të kuotave, pjesëtimi dhe transferimi i tyre do të bëhen sipas procedurave të parashikuara në ligjin Nr.9901 dt 14.04.2008” Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe nga statuti i shoqërisë.

### **Neni 8-Administrimi**

8.1 Administrator i parë i shoqërisë është **Znj.Fabiola Petritaj** e cila do të qëndrojë në detyrë për një periudhë 5 vjetecare me të drejtë rizgjedhje.

8.2 Do të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për rregjistrimin e Shoqërisë ne Qëndren Kombëtare të rregjistrimit të biznesit (QKB).

8.3 Të gjitha shpenzimet që do të kryhen deri në rregjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin e shoqërisë.

#### **Neni 9 Të tjera**

9.1 Shoqëria do ta ushtrojë veprimtarinë e saj sipas legjislacionit shqiptar. Kushtet e punës, shpërblimet, oraret, pushimet dhe sigurimet shoqërore të personelit do të rregullohen nga kontrata kolektive ose individuale tq punës si dhe ato nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

#### **Neni 10 Dispozita të fundit**

10.1 Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj misid ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të diskutohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë midis të interesuarve për t'I zgjidhur me mirëkuptim. Në rast të kundërt I nënshtohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

*Ky Akt Themelimi është përgatitur ne katër kopje me vlerë të njëjtë juridike.*

**Shoqëria GENERAL TRADING sh.p.k**

**ORTAK THEMELUES**

**Znj. Fabiola PETRITAJ**

